



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 10 Datë 26.01 2024

“Për dhenien e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Bajram Begaj.”

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; neni 9, pika 1.7, gërma a), neni 54, gërma m); Ligji nr 94/2023 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Neni 8, neni 9, neni 11, pika 2 gërma a; neni 13, neni 18, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vau Dejës:

VENDOSI:

1. Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës , Z. Bajram Begaj, President i Republikës së Shqipërisë.

Me motivacionin: *“Intelektual i shquar, mbartës i vlerave intelektuale e qytetare, shtetar i ekuilibruar, korrekt dhe i paanshëm! Për vëmendjen, dashamirësinë e miqësinë, e treguar për Vau Dejësin dhe banorët e tij”*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Sekretaria e Bashkisë Vau Dejës, duke qenë se është akt me karakter individual dhe hyn në fuqi pas njoftimit të subjekteve që përfshihen në to.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian ÇELEPIJA

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Ervis SHIMAJ

Miraturar me 20 vota

Vota Pro 20

Vota Kunder —

Vota Abstenim —

Zbardhur me datë 31.01.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT DHE TRASHIGIMISË KULTURORE

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 01 datë 19.01 2024

“Për dhenien e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Bajram Begaj.”

Në mbështetje të Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; neni 9, pika 1.7, gërma a), neni 54, gërma m); Ligji nr 94/2023 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Neni 8, neni 9; neni 11, pika 2 gërma a; neni 13, neni 18, Kryetari i Bashkisë, i propozonë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

VENDOSI

- Dhënia e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës , Z. Bajram Begaj, President i Republikës së Shqipërisë.
Me motivacionin: *“Intelektual i shquar, mbartës i vlerave intelektuale e qytetare, shtetar i ekuilibruar, korrekt dhe i paanshëm! Për vëmendjen, dashamirësinë e miqësinë, e treguar për Vau Dejësin dhe banorët e tij”*
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Sekretaria e Bashkisë Vau Dejës, duke qenë se është akt me karakter individual dhe hyn në fuqi pas njoftimit të subjekteve që përfshihen në to.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI

Kristian Shkreli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SE MJEDISIT
SEKTORI I ZHVILLIMIT TË TURIZMIT DHE TRASHIGIMISË KULTURORE
Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr. _____ prot.

Vau Dejës, më __, __, 2024

RELACION

PËR

“Për dhënien e titullit “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z. Bajram Begaj.

Bazuar në Ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkatësisht Neni 9, pika 1.7, gërma a), neni 54 gërma m);

Neni 9, pika 1.7, gërma a)... . Të drejtat dhe përgjegjësitë, 1.7. Të drejta të tjera, sipas të cilave:
a) japin tituj nderi dhe stimuj;

Neni 54 gërma m) Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, m) jep tituj nderi dhe stimuj;

Ligji nr 94/2023 “ Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”,
KREU III / Neni 8, neni 9; KREU IV / neni 11, pika 2 gërma a; neni 13:

Neni 8, Llojet e titujve vendorë të nderit ...Titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë janë titulli “Qytetar nderi” dhe tituj të veçantë vendorë nderi që jepen sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 9, Titulli “Qytetar nderi” 1. Titulli “Qytetar nderi” jepet nga këshilli bashkiak për veprimtari të shquar, kontribute dhe merita të veçanta në shërbim dhe në dobi të bashkisë ose për veprimtari për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të komunitetit brenda territorit të bashkisë. 2. Titulli “Qytetar nderi” u jepet edhe personaliteteve të huaja të nivelit të lartë, që vizitojnë një bashki në kuadër të një vizite zyrtare ose shtetërore.

Neni 11, pika 2 , Propozimi për dhënien e titullit vendor të nderit paraqitet nga: a) kryetari i bashkisë;

Neni 13, Propozimi për nderim

Mbështetur në legjislacionin e parashikuar për dhënien e titujve të nderit, duke e respektuar parashikimet e tij, duke u legjitimuar nga neni 11, pika 2 e Ligjit nr 94/2023, propozoj dhënien e titullit “ Qytetar nderi” për:

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Z. Bajram Begaj, propozohet ti jepet titulli “ Qytetar nderi”, me motivacionin “*Intelektual i shquar, mbartës i vlerave intelektuale e qytetare, shtetar i ekuilibruar, korrekt dhe i paanshëm! Për vëmendjen, dashamirësinë e miqësinë, e treguar për Vau Dejësin dhe banorët e tij*”.

Historik i shkurtër :

Bajram Begaj (lindur më 20 mars 1967) është një politikan shqiptar dhe oficer ushtarak në pension, i cili aktualisht shërben si president i Shqipërisë që nga 24 korriku 2022. Me një karrierë të gjatë në ushtrinë shqiptare, ai shërbeu si Shefi i 26-të i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare nga korriku 2020 deri në qershor 2022.

Edhe pse i pavarur politikisht, më 3 qershor 2022, Begaj u propozua zyrtarisht nga Partia Socialiste në pushtet si kandidat për raundin e katërt të zgjedhjeve presidenciale 2022. Begaj është presidenti i pestë në historinë e Shqipërisë me formim ushtarak, pas Ahmet Zogut, Ramiz Alisë, Alfred Moisiut dhe Bujar Nishanit.

Begaj ka lindur më 20 mars 1967, në Rogozhinë. Ai u diplomua në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë në vitin 1989 dhe u bë mjek aktiv në vitin 1998. Pasi ka përfunduar doktoraturën profesionale mban titullin “Profesor i Asociuar” në Mjekësi.

Gjatë karrierës së tij ushtarake 31-vjeçare, Begaj ka marrë pjesë në seminare të shumta trajnimi dhe ka përfunduar kurse në Siguri dhe Mbrojtje, Shkollën e Avancuar Pasuniversitare të Mjekësisë, Specializim Pasuniversitar në Gastrohepatologji, Kursin e Menaxhimit Spitalor dhe Kursin Strategjik të Udhëheqjes Mjekësore në Shtetet e Bashkuara, një kurs specializimi në mjekësi dhe një kurs shëndetësor në Greqi.

Begaj ka shërbyer më parë si Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes në Forcat e Armatosura Shqiptare. Ai ka mbajtur poste të tjera të ndryshme duke përfshirë: Shef i Njësisë Mjekësore Ushtarake dhe Zëvendës Drejtor Ushtarak i USHT-së, Drejtor i Spitalit Ushtarak, Drejtor i Inspektoriatit Shëndetësor etj. U emërua Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare në korrik 2020 dhe mori detyrën më vonë atë muaj.

Z. Begaj ka vizituar Bashkinë Vau Dejës, me datë 27.10.2023, gjatë vizitës së tij tregoi vëmendje të veçanta ndaj komunitetit të bashkisë dhe problematikave të këtij komuniteti , ofroi mbështetje dhe zgjidhje konkrete për disa problematika.

Nder to ajo e ngritjes se nje shtëpie sociale për fëmijët me nevoja të vecanta .

Vetëm pak javë me vonë nën kujdesin e Zyrës së Presidentit , do të bëhej e mundur sjellja për tre jave ne territorin e Bashkisë Vau Dejës , Bushat e Hajmel Mamografia lëvizëse. Zonja e parë do ishte prezent për të parë dhe inkurajuar nga afër grate e zones dhe stafin mjekësor .

Zonja e parë mori pjesë dhe po tregon interes të veçantë për fëmijet me nevoja të vecanta , e pranishme në ekspozitën e tyre pranë Dioqezës së Sapes. Po punohet midis dy institucioneve për të ndihmuar dhe konkretizuar disa aktivitete dhe ndihmë konkrete.

Ka një plan pune dhe kordinimi për të ardhur në ndihmë , kryesisht për gratë dhe fëmijët .

Me datë 10.01.2024, me Vendimin nr 2, të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, është ngritur Komisioni Këshillimor “ Për dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve ose titujve vendor të nderit”, ku anëtar të këtij komisioni janë punonjës të Bashkisë Vau Dejës dhe dy anëtar të jashtëm , figura të njohura të kësaj bashkie. Me date 10.01.2024, me propozimin nr 177/1, është bërë propozim nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, për dhënien e titujve të nderit, siç u përmendën më sipër. Ky propozim i kaloi për shqyrtimin, komisionit këshillimor, i cili me datë 11.01.2024, me procesverbalin nr 177/2, ka vlerësuar se propozimi i kryetarit të bashkisë, i plotëson kriteret e kërkuara nga ligji dhe ka vendosur miratimin e këtij propozimi. Pas miratimit të propozimit nga komisioni këshillimor, është hartuar projekt vendimi për dhënien e titujve të nderit.

Duke shprehur në miratimin e këtij materiali nga ana juaj,

KRYETARI
Kristian Shkreli

